

**Vendime të miratuara në mbledhjen e Këshillit të Ministrave, datë 12 Prill 2017**

**V E N D I M  
P Ë R**

**MIRATIMIN E BONUSIT NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË PËR DHËNIEN ME KONCESION/PARTNERITET PUBLIK PRIVAT TË KOMPLETIMIT DHE NDËRTIMIT TË RRUGËS SË ARBRIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 6, të nenit 25, të ligjit nr.125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, dhe në vijim të pikave 1 e 2, të nenit 15, “Dhënia e bonusit”, të rregullave për vlerësimin dhe dhënie me koncesion/partneritet publik privat të punëve publike dhe shërbimeve për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale, të miratuara me vendimin nr.634, datë 1.10.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënie me koncesion/partneritet publik privat të punëve publike dhe shërbimeve për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e bonusit prej 10 (dhjetë) % të pikëve, që i jepet shoqërisë “Gjoka konstrukcion”, sh.a., për rezultatin teknik dhe financiar të propozimit të pakërkuar, të paraqitur për procedurën e koncesionit/partneritetit publik privat për kompletimin dhe ndërtimin e Rrugës së Arbrit.
  2. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

**K R Y E M I N I S T R I  
E D I R A M A  
Në mungesë dhe me porosi  
ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
N I K O P E L E S H I**

\*\*\*